




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT- Raport vjetor (janar – dhjetor 2025)



**DREJTORIA E ARSIMIT
NË DEÇAN**

04.256 - ZILAZNA - 01/01/2025
REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANE - DEÇAN MUNICIPALITY

Nr. 01/2025
Org. DRJ. ARSIMIT
No. 01/2025

1967
02
26.01.2026

DEÇAN DEÇANE

Raporti i punës së Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) paraqitur kryetarit të komunës për muajt (janar – qershor – korrik – dhjetor të vitit 2025.

Të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Drejtorisë janë realizuar gjatë kësaj periudhe më përkushtim dhe më përgjegjësi të plotë.

Me prezantimin e këtij raporti do të jeni më afër të njohur dhe të informuar sidomos në aspektin zyrtar për punën, organizimin dhe zhvillimin transparent të politikave arsimore në Deçan.

Procesi arsimor gjatë këtij viti ka qenë vazhdimisht i përcjell me kujdes nga Departamenti jonë, ku të gjitha institucionet arsimore janë vizituar disa herë, si nga ana e Drejtorit, ashtu edhe nga zyrtarët e arsimit.

Kemi realizuar mbledhje të rregullta me drejtorë të institucioneve shkollore.

Janë mbajtur takime të rregullta edhe më MASHTI-in, ku çdo detyrë e dhënë nga ana e tyre është realizuar me sukses nga ana jonë.

STRUKTURA ORGANIZATIVE - Këtë sektor e përbejnë 6 punëtor:

Drejtori, 1 Udhëheqës sektori administrativ,

1 Udhëheqësi i sektorit për arsim,

1 Përgjegjësjë për Buxhet dhe Financa

1 Zyrtari për Arsimin e Mesëm të Lartë

1 Zyrtari Ligjor

1 Zyrtari për Arsimin Fillor

1 Zyrtari i Lartë Administrativ

- Në menaxhim të komunës janë 20 objekte shkollore të arsimit parauniversitar,
- Deçani ka një Institucion parashkollor (publiko - privat) dhe një privat, në ndërtim e sipër institucioni publik në hapsirën e SHFMU “Lidhja e Prizrenit”
- 18 shkolla fillore dhe të mesme të ulta,
- 2 shkolla të mesme të larta,
- Ku punojnë gjithsejtë 574 punëtor dhe ndjekin mësimin e rregullt rreth 4416 nxënës. 33 punëtor administrativ, 420 mësimdhënës, 85 punëtor teknik.

- Nuk ka asnjë institucion arsimor të pajisura me sisteme të energjisë solare.

- Nuk ka asnjë institucion arsimor të pajisur me sisteme gjeotermale.

- Janë 17 institucione arsimore të pajisura me masa për kursimin e energjisë.

- 20 institucione arsimore janë të pajisura me rrethoja të objekteve.

- 19 institucione arsimore janë të cilat kanë dorzuar raportin përmbledhës në DKA 2 herë në vit.

- 19 institucione arsimore janë të pajisura me sisteme të kamerave të sigurisë.

- 10 institucione arsimore janë të pajisura me sallë të edukatës fizike me mjete dhe pajisje,

- 6 institucione arsimore janë të pajisura me kabinete (laboretore, punëtori)
- 15 institucione arsimore janë të pajisura me bibliotekë të shkollës në funksion,
- 18 institucione arsimore janë të pajisura me kabinete të TIK-ut me mjete dhe pajisje në funksion,
- 20 Numri i objekteve shkollore të nivelit parauniversitar, të pajisura me klasa të zakonshme të pajisura me orendi të domosdoshme shkollore;
- 12 institucion arsimor parauniversitar është e pajisur me një klasë të zakonshme me orendi dhe pajisje të domosdoshme shkollore.
- Rezultati i arritur në testin e arritshmërisë për klasat e 9-ta në vitin shkollor 2024/2025 ishte 47.94%
- Rezultati i arritur nga vajzat në testin e arritshmërisë për klasat e 9-ta në vitin shkollor 2024/2025 ishte 45.71%
- Numri i nxënësve të cilët kanë mbaruar klasën e 12-të ishte 294 nxënës.
- Numri i nxënësve me rezultatu mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa e 12 ishte 239 nxënës.
- Numri i nxënësve vajza të cilat kanë mbaruar klasën e 12-të ishte 140 nxënëse.
- Numri i nxënësve vajza me rezultate mbi pragun e kalueshmërisë në testin e maturës shtetërore klasa e 12-të ishte 133 nxënëse.
- Numri i fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në klasat e rregullta deri në klasen e 12-të është 34.
- Numri i asistenteve për nxënës me nevoja të veçanta në klasat e rregullta në komunë në nivelet ISCED 1, 2, dhe 3 është 17.
- Gjithsej numri i orëve të planifikuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ishte 288142 orë mësimore.
- Gjithsej numri i orëve të realizuara sipas kalendarit shkollor në të gjitha institucionet ishte 278957 orë mësimore.
- Nuk ka pasur raste të braktisjes së shkollimit nga ana e nxënësve për nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (ISCED 1 dhe 2).

Aktivitetet më të rëndësishme të realizuara :

- Mbledhje të rregullta, dhe takime ditore, javore me drejtorë të institucioneve shkollore janë realizuar në vazhdimësi. Në këto takime është kërkuar angazhim edhe më i madh i mësimdhënësve për ngritjen e cilësisë në arsim, respektim në përpikëri të ligjeve, udhëzimeve dhe rregulloreve në fuqi.
- Mbledhje të rregullta me Ministrinë e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit.
- Vlerësimi i performancës së brendshme dhe të jashtme të shkollave nga vlerësimi i brendshëm (DKA) janë vlerësuar drejtor/e të institucioneve publike të arsimit parauniversitare edhe nga vlerësimi i jashtëm me performancë të shkëlqyer dhe të mirë.
- Pranimi i raporteve të rregullta në baza ditore, javore, mujore, vjetore nga të gjithë drejtorët e shkollave. Interesimi dhe angazhimi i të gjithë akterëve (personelit arsimor, prindërve, nxënësve, stafit mbështetës etj.) ishte qenë në nivel.
- Është realizuar studimi rapid i të gjitha shkollave me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta në secilën shkollë në mënyrë që të jenë inputë për hartimin e strategjisë së arsimit në nivel komunal
- Në ngritjen e cilësisë së arsimit në përgjithësi ka ngritje dhe kushte më të mira për nxënës dhe personel.
- Deçani tashmë i prinë disa komunave në nivel vendi sa i përket sukseseve në lëndë të ndryshme shkollore, garat komunale dhe ato mbarëkombëtare .
- DKA është vlerësuar nga SIA –MASHTI për zbatueshmërinë e normativit dhe fondit të orëve, ku i prijmë komunave të Kosovës.
- DKA është vlerësuar nga divizioni për ngritje dhe zhvillim profesional të mësimdhënësve nga MASHTI për suksesin e lartë të arritur dhe prijmë para të gjitha komunave të Kosovës.
- Mbikëqyrja në institucionet edukative arsimore, sipas objektivave të paraparë nga ana e zyrtarëve dhe drejtorit të DKA-së, ku zyrtarët kanë mbështetur stafin e shkollave me këshilla profesionale.
- Përgatitjet dhe organizimi e testeve : të arritshmerisë, maturës shtetërore 2025, testi PIRLS, testi TIMMS dhe këtë është realizuar edhe testi ndërkombëtar PISA me nxënës të moshave 15-të vjeqare.
- Janë realizuar planifikimet për fondin e orëve të klasave me kurrikulën e re dhe zbatimin e udhëzuesit për ndarjen e orëve me zgjedhje.

- Sa i përketë realizimit të fondit të orëve si dhe procedurave rekrutuese të konkurseve sipas SIA –MASHTI (regjioni i Pejës) DKA Deçan i prinë të gjitha komunave në regjionin e Pejës.
- Mbatja e garave komunale në lëndën: matematikë, fizikë dhe kimi duke bashkëpunuar me organizatat në nivel nacional dhe kombëtare.
- Mbatja e ligjëratave në shkolla nga Policia e Kosovës, lidhur me parandalimin e dukurive negative të nxënësit dhe të rinjtë (ligjëratat me tema specifike janë mbajtur çdo muaj, me fokus grupe).
- Publikimi i konkurseve dhe regjistrimi i fëmijëve si dhe nxënësve në institucionet arsimore si: institucioni parashkollor, dhe në klasat e para.
- Edhe këtë vit kemi vazhduar trajnime me disa grupe mësimdhënësish me Organizatën “Lions Club Peja”.
- Drejtori i Drejtorisë Komunale të Arsimit, gjatë kësaj periudhe ka pasur takime bashkëpunimi me institucione dhe organizata të ndryshme, ku janë shtjelluar tema të ndryshme që kanë të bëjnë me zhvillimin, mbështetjen dhe avancimin e procesit mësimor dhe reformave në arsim: Ekspert të arsimit nga BE, Fakulteti i Edukimit, përfaqësuesit e GIZ-it, për sa i përket trajnimeve dhe zhvillimit profesional të mësimdhënësve me Institutin Pedagogjik të Kosovës, KOSED, KFOR-in, Lions Club Peja, Down Syndrom Kosova, OJQ “Jeta” etj.
- Takim informues zyrtaret e MASHTI-t më mësimdhënës të fushave dhe niveleve të ndryshme për përmisimin e teksteve shkollor.
- Futja e të dhënave statistikore për numrin e fëmijëve dhe personelit, në sistemin EMIS-MASHTI.
- Në mënyrë të vazhdueshme bëhet integrimi në institucione arsimore dhe trajtimi i fëmijëve me nevoja të veçanta.
- Në fushën e psikologjisë, me psikologë të shkollave gjatë punës së vazhdueshme profesionale, në vitin 2025 kemi mbajtur puntori për vetëdijesim të nxënësve lidhur me parandalimin e dukurive negative, në të gjitha shkollat kemi mbajtur në formë relative puntori me tema të rëndësishme të cilat janë shumë të rëndësishme për zhvillimin e tyre, si;
 1. Bullizmi dhe masat parandaluese,
 2. Pasojat e narkotikeve,
 3. Dhuna në Familje,
 4. Masat e sigurisë ndaj keqpërdorimit të Internetit,
 5. Parandalimi i ngacmimeve Seksuale dhe masat ndëshkimore ligjore,
 6. Respektimi i shumëllojshmërisë së shoqërisë me qëllim të parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të dhunshëm,
 - 7.

Siguria e qarkullimit të këmbësorëve në trafik, 8. Ruajtja e ambientit dhe e trashëgimisë kulturore.

- Në këtë periudhë kemi pas bashkëpunim me asistent të FAMNV, për të ndihmuar në procesin e mësimit për FAMNV, të asistoj në hartimin e PIA për mësime të cilët nuk kanë pasur mundësi të hartojnë këtë plan i cili është mjaft sfidues si punë fillestare për mësuesit të cilët duhet ta kenë si plan të rregullt për këta fëmijë.
- Gjatë kësaj periudhe kemi trajtuar në aspektin psikologjik rastet të cilat kanë pasur nevojë për këtë trajtim; familjet për fëmijët e vet, institucionet arsimore, QPS.
- Në vazhdimësi janë organizuar punëtori dhe takime me temën: Diskutim rreth detyrave përgjegjëse dhe vështirësive të Asistentëve për fëmijë/nxënës më nevoja të veçanta arsimore, gjatë kryerjes së punës dhe detyrave të tyre. Takimet u organizuan nga koordinatori i Ekipës Komonale për vlerësim pedagogjik të fëmijëve me nevoja të veçanta z. Ramiz Bajramaj nga DKA, kurse u realizuan nga psikologjia Besarta Idrizi dhe Florenta Molliqaj. U diskutuan problematika, vështirësitë që asistentët hasin në punën e tyre me fëmijë me nevoja të veçanta po ashtu u shkëmbyen përvoja u dhanë këshilla e sugjerime rreth kësaj pune sa sfiduese dhe e ndjeshme njëkohësisht.
- Për nder të 7 Marsit, ditës së mësuesit, Drejtori i Arsimit, u ndau mirënjohje për mësime të komunës së Deçanit.
- Çdo vit me datën 7 Mars në Ditën e Mësuesit, Ministria e Arsimit ndan çmimin “Shaban Jashari” dhe mirënjohje për mësime të përkushtuar dhe të dalluar në profesionet e tyre, në mesin e shumë mësime të tillë, Drejtoria e Arsimit e ka propozuar mësime në SHFMU “Faik Konica” në Ratishë z. Ahmet Ukaj të cila mirënjohjen në këtë ditë të shënuar.
- Në organizim të DKA-së, u mbajt trajnimi për 38 mësime të shkollave tona. Trajnimi "Zbatimi i kurrikulës së re" e udhëhoqi Dr. Pedagogu Hysen Balaj. Gjatë trajnimit, mësime të vizitohet Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, ku i inkurajohet mësime të informatat e përfituara në trajnim t'i praktikojnë më nxënës të tyre, gjithashtu i siguroj ata që trajnime dhe punëtori të tilla do të organizohen edhe në të ardhmen. U certifikuan 38 mësime të gjitha niveleve.
- Ekipi komunalë për parandalim të braktisjes së shkollës është marr me rastet që kanë pasur tendencë braktisje.
- U hartua Plani Zhvillimor i Arsimit Komunal nga ekspert të shkollave tona dhe bashkëpunëtor i jashtëm Prof Dr.sc Ramë Likaj.
- Drejtoria e Arsimit në Deçan në bashkëpunim më zyrën e kryetarit të komunës ka organizuar festën e Abetares së bashku për të gjitha shkollat e komunës sonë, .

- Në bazë të Udhëzimit Administrativ Nr.09/2023 për regjistrimin e fëmijëve në klasën e parë, po bëhet vlerësim i fëmijëve. Pas raportit dhe rekomandimeve të marrura nga ky vlerësim drejtorja e shkollës do të merr vendim për regjistrimin e këtyre fëmijëve në klasën e parë.
- DKA ishte në disa shkolla pjesëmarrëse në manifestimin e Ditës së shkollës,
- Bashkë me zyrën e Kryetarit z. Bashkim Ramosaj, janë organizuar takime informuese me mësime të shkollave tona, ku në bashkëpunim me grupin punues për hartimin e Planit Zhvillimor të Arsimit Komunal, u prezantua strategjia dhe prioritetet e shkollave që do të implementohen gjatë viteve 2024 - 2027. Ky dokument strategjik është një udhërrëfyes për mënyrën se si duam të edukojmë brezat e rinj dhe për nivelin që duam të arrijmë në të ardhmen e afërt. Është gjithmonë i bazuar në kërkesat e domosdoshme të shkollave dhe kohës, duke u krahasuar me nivelet regjionale dhe evropiane.
- Trajnim për ngritjen e kapaciteteve të mësime të shkollave për rishikimin dhe përmirësimin e teksteve shkollore
Mësime nga të gjitha nivelet e arsimit kanë ndjekur trajnimin me temën:
“Ngritja e kapaciteteve të mësime të shkollave për rishikim dhe përmirësim të teksteve shkollore.”
Qëllimi i trajnimit është:
 - Ngritja e kapaciteteve profesionale të mësime të shkollave për vlerësimin dhe rishikimin e teksteve shkollore që janë në përdorim.
 - Përmirësimi i cilësisë së teksteve, në funksion të ngritjes së nivelit të mësime të shkollave dhe të performancës së nxënësve dhe mësime të shkollave.
 Trajnimi është i akredituar nga MASHTI, implementohet nga IPK-ja dhe organizohet nga KOSED, në bashkëpunim me DKA-në.
Gjatë trajnimit, do të analizohen, vlerësohen dhe rishikohen këto tekste shkollore:
 1. Shoqëria dhe mjedisi – Klasa 3
 2. Shoqëria dhe mjedisi – Klasa 2
 3. Histori – Klasa 9
 4. Gjeografi – Klasa 9
 5. Edukatë qytetare – Klasa 9
- U mbajt Testi i Arritshmërisë për klasat e nënta
Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI) në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA-në), ka organizuar Testin e Arritshmërisë për klasat e nënta,
I cili është mbajtur në 3 qendra të testimit në SHFMU "Lidhja e Prizrenit", ku nxënësit janë sistemuar në 13 salla testimi.
Në këtë proces kanë marrë pjesë 370 nxënës nga shkollat e komunës sonë, testi ka filluar me kohë dhe nuk është evidentuar asnjë parregullsi.
DKA falënderon të gjithë akterët e përfshirë në organizimin dhe zbatimin e Testit të Arritshmërisë për angazhimin dhe bashkëpunimin e treguar.
- Vizita të vazhdueshme në shkolla monitoruese dhe mentoruese nga zyrtaret e DKA-së.

- Shpallja e Konkursit për regjistrimin e nxënësve në klasën e dhjetë në Gjinnaz dhe IAAP.
<https://decan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2023/07/konkurs-regjistrimi-nx-2023-1.pdf>

https://decan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/08/DKA_Konkurs-plotesues-per-klasat-e-10-ta_Afati-i-Gushtit-2025.pdf
- Ka përfunduar me sukses pjesa e parë e Provimit të Maturës Shtetërore edhe në komunën tonë
 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), ka organizuar me sukses pjesën e parë të Provimit të Maturës Shtetërore, duke vlerësuar lart organizimin dhe administrimin e këtij procesi të rëndësishëm arsimor.
 Provimi është mbajtur në dy qendra testimi, në Gjinnazin “Vëllezërit Frashëri” dhe në IAAP “Tafil Kasumaj”, ku maturantët janë sistemuar në 19 salla.
 Testi ka filluar në kohë dhe nuk është evidentuar ndonjë parregullsi e theksuar.
 Megjithatë, për shkak të përdorimit të telefonit gjatë testit, një nxënës është përjashtuar nga procesi i testimit.
 DKA falënderon të gjithë akterët e përfshirë në organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore.
 Një falënderim i veçantë u drejtohet: policëve kujdestarë nga Stacioni Policor i Deçanit, drejtorëve të shkollave, koordinatorëve të qendrave të testimit, administruesve nga Komuna e Pejës, si dhe vetë maturantëve tanë, të cilët dëshmuuan një nivel të lartë përgjegjësie dhe kulturë qytetare.
 Maturantëve tanë u urojmë fat dhe suksese në këtë hap të rëndësishëm të jetës së tyre!
- U Mbajt Debati Publik për Projekt – Buxhetin 2025/27 – Granti për Arsim.
 U kryesua nga Kryesuesi, z.Hajdar Sutaj, te pranishme ishin drejtoresha për Buxhet dhe Financa, znj. Dafina Cacaj, drejtori për Arsim, z. Besnik Hulaj, drejtorët e shkollave, zyrtar komunal.
 Drejtoresha Cacaj shpalosi para të pranishmëve se si është planifikuar të bëhet ndarja e buxhetit për sektorin e Arsimit, ajo dha sqarimet e nevojshme sa i përket kësaj çështje.
 Drejtorët e shkollave paraqiten kërkesat dhe nevojat e tyre për projekt buxhetin e vitit 2025/2027
 Pati diskutime të vogla, pyetje dhe sugjerime nga Drejtorët e shkollave të cilve ju përgjigje drejtori Hulaj si dhe drejtoresha Cacaj, më shumë në vija të përgjithshme se çka nevojitet të punohet e të investohet më shumë në shkolla.
- Ka përfunduar me sukses pjesa e dytë e Provimit të Maturës Shtetërore edhe në komunën tonë.
 Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA), ka organizuar me sukses pjesën e dytë të Provimit

të Maturës Shtetërore, duke vlerësuar lart organizimin dhe administrimin e këtij procesi të rëndësishëm arsimor.

Provimi është mbajtur në një qendër testimi, në IAAP "Tafil Kasumaj", ku maturantët janë sistemuar në 6 salla.

Testi ka filluar në kohë dhe nuk është evidentuar ndonjë parregullsi e theksuar.

DKA falënderon të gjithë akterët e përfshirë në organizimin dhe mbarëvajtjen e Provimit të Maturës Shtetërore.

Një falënderim i veçantë u drejtohet:

Zyrtarëve nga MASHTI, për korrektësinë dhe profesionalizmin e treguar,

Policëve kujdestarë nga Stacioni Policor i Deçanit,

Drejtorëve të shkollave, koordinatorëve të qendrave të testimit, administruesve nga Komuna e Pejës, si dhe vetë maturantëve tanë, të cilët dëshmuuan një nivel të lartë përgjegjësie dhe kulturë qytetare.

Maturantëve tanë u urojmë fat dhe suksese në këtë hap të rëndësishëm të jetës së tyre!

- Urimi i drejtorit të DKA-së me rastin e fillimit të vitit shkollor 2025/2026

Të dashur nxënës e prindër!

Të nderuar mësues e kolegë!

Urimet më të mira për vitin e ri shkollor 2025-2026!

Dëshiroj t'ju drejtohem të gjithëve me një urim të përzemërt dhe me dëshirën, që të gjithë së bashku të punojmë për të patur një vit shkollor sa më produktiv e cilësor. Një urim të veçantë për të gjithë fëmijët që ndjekin klasën e parë.

Dita e parë e shkollës është një moment ngazëllues, emocional dhe mbi të gjitha me një rëndësi të madhe, pasi i jep të gjithëve besim: mësuesve në punën e tyre plot sfida, prindërve në synimin për shërbim cilësor dhe nxënësve për arritje të shkëlqyera. Është moment për të reflektuar në rolin madhor që ka edukimi në shoqëri.

Të nderuar kolegë!

Fëmijët e nxënësit janë nën petkun e punës tuaj. Kur bëhet fjalë për shkollën, flasim për fatin e vendit tonë. Ndaj shkolla duhet të përgatisë dhe të edukojë qytetarë të vetëdijshëm dhe njerëz të aftë për t'u përballuar me sfidat e jetës. Bëjini nxënësit tuaj të kuptojnë dijen, me qëllim që ta kthejnë atë në aftësi. Është detyra jonë.

Të dashur nxënës!

Shpresoj dhe besoj se çdo vit shkollor, ashtu edhe ky vit, duhet të jete një kontribut i çmuar në formimin tuaj, si nxënës, si qytetarë e mbi të gjitha si njerëz. Prandaj angazhohuni dhe studioni seriozisht. Bëhuni protagonistë të jetës shkollore, duke përcjellë aftësi, pozitivitet, ekukatë, bashkëpunim, tolerancë, arritje. Shkolla është një vlerë që do ju vlejë për të gjithë jetën. Përpiquni të punoni fort, për arritje të suksesshme. Është detyra juaj.

Të dashur prindër!

Bashkëpunoni pa hezitim me mësuesit e fëmijët tuaj, për të arritur synimet që ju keni. Bëhuni sa më shumë pjesë e shkollës, sepse këshilla juaj është ndihma jonë.

Me dëshirën që gjithësecili do të kontribuojë maksimalisht dhe me shumë përgjegjësi për një arsim sa më cilësor, ju uroj:

Suksese dhe mbarësi për vitin shkollor 2024-2025!

Besnik Hulaj

Drejtore në Drejtorinë e Arsimit

- Me 1 Shtator 2025 u bë përvjetori i shkollës së re “Lan Selimi” në Lumbardh, shiritin e prentë Familjari i Lan Selimit, Ministresha e Arsimit znj. Arberie Nagavci dhe drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj.

Në ngjarjen solemne ishte edhe Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj, ku adresoj një urim për nxënësit, mësuesit dhe komunitetin:

“Me rastin e fillimit të vitit të ri shkollor, pata kënaqësinë dhe gëzimin e madh të përurojmë objektin e ri të shkollës fillore “Lan Selimi” në Lumbardh.

Jam i lumtur që sot fëmijët e këtij fshati e nisin vitin shkollor në një shkollë moderne, me infrastrukturë më të mirë, ku do të mësojnë, ëndërrojnë dhe rriten në kushte më të denja.

Në këtë ditë të veçantë ishte e pranishme edhe Ministria e Arsimit, znj. Arbërie Nagavci, me të cilën ndamë emocionin dhe gëzimin e fillimit të ri.

Urime dhe suksese për të gjithë nxënësit dhe mësuesit në këtë vit të ri shkollor! Bashkim Ramosaj”.

- Vizita në shkolla nga Ekipa Mbeshtetëse Psikologjike – Pedagogjike në shkolla.
- Takimi radhës me përfaqësuesen e Shoqatës Down Syndrome Kosova - dega në Prizren, me znj. Grenita Grazhda, zyrtarin e DKA-së Ramiz Bajramaj, Psikologën znj. Besarta Tahirukaj - Idrizi dhe Psikologën Edita Tahirsylaj, asistente mbështetëse. Gjatë takimit u diskutua puna e Komisionit Komunal, për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, sfidat gjatë punës së komisionit, nevojat imediate për trajnim dhe seminare të asistentëve, mundësitë e bashkëpunimit me Shoqatën edhe në të ardhmën.

- Drejtorja e Arsimit në Deçan sot zhvilloi një takim pune me përfaqësuesit e Policisë së Kosovës!

Në takim u diskutua për fillimin e vitit të ri shkollor dhe u theksua rëndësia e vazhdimin të bashkëpunimit ndërinstitucional mes Policisë dhe Drejtorisë së Arsimit, me fokus në:

- Sigurinë në institucionet arsimore;
- Rritjen e sigurisë në komunikacionin rrugor, sidomos pranë shkollave;
- Planifikimin e ligjëratave sensibilizuese dhe vetëdijesuese për parandalimin e sjelljeve negative në ambientet shkollorë.

Ky bashkëpunim synon krijimin e një mjedisi të sigurt për nxënësit tanë dhe zhvillimin e një procesi mësimor pa pengesa.

Falënderojmë zyrtarët policorë për kujdesin dhe bashkëpunimin e vazhdueshëm ndër vite.

- Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj vizitoj disa institucione të arsimit, në llogarinë e tij të Facebook-ut adresoj një urim,
 “Sot pata kënaqësinë të vizitoj me respekt dhe admirim disa prej institucioneve më të rëndësishme të arsimit në komunën tonë, Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri”, IAAP “Tafil Kasumaj” si dhe shkollat në fshatrat Strelc i Epërm, Strelc i Ulët, Irzniq, Prilep dhe Gllogjan.
 Në prag të fillimit të një viti të ri shkollor, dua t’i uroj nxënësve, mësuesve dhe gjithë stafit arsimor një vit plot suksese dhe arritje.
 Ju falënderoj për përkushtimin dhe ju siguroj se mbështetja për arsimin do të mbetet prioriteti ynë, për të garantuar kushte të përshtatshme dhe një ambient të sigurt dhe stimulues për të gjithë nxënësit.
 Me respekt,
 Bashkim Ramosaj”
- Komisioni Komunal për Vlerësimin Pedagogjik të Fëmijëve me Nevoja të Veçanta Arsimore, fillon punën në vlerësimin dhe rivlerësimin pedagogjik të fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, bazuar në UA MASHTI nr. 16/2017 dhe 02/2024.
- DKA ka nënshkruar Memorandum Mirëkuptimi me Organizatën "Teach For Kosova", për projektin "Let Girls Thrive" i cili projekt do të realizohet në SHFMU "Lidhja e Prizrenit" Deçan.
- U çertifikuan 70 mësime dhënë
 Në Sallën e Asamblesë Komunale në një solemnitë, u ndanë çertifikata për 70 mësime dhënë deçanas, të cilët përfunduan me sukses trajnimet për "Të meduarit logjik, kritik dhe krijues në mësime dhënë dhe mësime nxënë", të mbajtur nga Pedagogu Dr.sc. Hysen Balaj, si dhe trajnimin më bazë në shkollë me temën “Aktivat profesionale në shkollat e Kosovës – roli dhe funksioni i tyre”, trajnimin e mbajti Prof Msc. Burim Avdiaj, trajnimi u zhvillua në SHFMU “Drita” në Gramaçel dhe “Maxhun Çekaj” në Irzniq, trajnimin e ndjekën mësime dhënë nga shkollat e “Drita”, “Dëshmorët e Baballoqit”, “Maxhun Çekaj” dhe “Kuvendi i Verrave të Llukës”.
 Çertifikatat i ndanë, Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, Koordinatori Komunal – Zyrtari i Lartë z. Zeqë Malaj, Dr.sc. Hysen Balaj - trajner, Msc. Burim Avdiaj.
 DKA, falenderon Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj për përkrahjen e vazhdueshme në ofrimin e kushteve në ngjarje të rëndësishme për arsimin deçanas.
- Komuna e Deçanit i bashkohet aktivitetëve të Kodimit!
 Sot, nxënësit e klasës së 4 nga shkolla "Dëshmorët e Baballoqit" në Deçan, së bashku me mësuesen e tyre, Cyme Mataj, u angazhuan në një aktivitet të veçantë të kodimit në CODE.ORG

Gjatë aktivitetit, ata mësuan për krijimin e Sprites, duke shfaqur kreativitetin e tyre në krijimin dhe animimin e karaktereve të ndryshme.

Ky aktivitet është një hap drejt të ardhmes digjitale dhe një mundësi fantastike për nxënësit që të mësojnë bazat e programimit në një mënyrë argëtuese dhe edukative.

- Drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj, takoi asistentët e punësuar në shkollat e komunës sonë, si dhe një pjesë të stafit profesional pedagogjik-psikologjik në kuadër të DKA-së. Ndër të tjera, Drejtori Hulaj pati një porosi të veçantë për asistentët: "Bëni atë që nuk thuhet, atë që nuk shihet dhe atë që nuk arrihet." Deçani është lider në arsimin gjithëpërfshirës.

- Shpallet Konkursi për ndarjen e bursave për studentët deçanas.
<https://decan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/09/Konkurs-1.pdf>

- Testi PISA në IAAP "Tafil Kasumaj" dhe Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri"
Në ambientet e IAAP "Tafil Kasumaj" dhe Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri", u zhvillua Testi PISA me nxënës të gjeneratës së vitit 2009.

Për mbarëvajtjen e testit u kujdes koordinatoresha, profesoresha Fatime Kukalaj, ndërsa për mirëmbajtjen e pajisjeve teknologjike dhe funksionimin e internetit u kujdes specialisti i IT-së, Remzi Dautaj dhe prof. Ermir Imami.

Gjatë zhvillimit të testit, nxënësit i vizitoi drejtori i DKA-së, z. Besnik Hulaj, i cili u uroi sukses nxënësve dhe falënderoi akterët e përfshirë në këtë proces për angazhimin e tyre të palodhur.

- Rezultatet e Garës nga Olimpiada Komunale e Matematikës
Me 13-12-2025 në lokalet e IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan, u mbajt Olimpiada Komunale e Matematikës, ku morën pjesë rreth 170 nxënës të shkollave të Komunës sonë. Nga kjo garë u përzgjedhën këta nxënës që do ta përfaqësojnë komunën tonë në Olimpiadën Matematike të Kosovës, që mbahet me 10-01-2026 në Prishtinë.

Pas kontrollimit të testeve nga komisioni vlerësues u përzgjedhën këta nxënës:

- Klasa e VII
 1. Basri Mataj - "Dëshmorët e Vokshit" Pobërgjë
 2. Sara Çekaj - "Maxhun Çekaj" Irzniq
- Klasa e VIII
 1. Arsa Tishukaj - "Isa Boletini" Isniq
 2. Taulant Salihu - "Drita" Gramaçel
- Klasa e IX
 1. Erion Bozhdaraj - "Sylejman Vokshi" Prejlep
 2. Onida Likaj - "Lidhja e Prizrenit" Deçan
 2. Erland Leci - "Rexhep Kadrijaj" Rastavicë
- Klasa e X

- 1. Enkela Zeqiraj - "Vëllezërit Frashëri" Deçan
- 2. Agon Muçaj - "Vëllezërit Frashëri" Deçan
- Klasa e XI
 - 1. Andi Osdautaj - "Vëllezërit Frashëri" Deçan
 - 2. Art Qorraj - "Vëllezërit Frashëri" Deçan
- Klasa e XII
 - 1. Adeonë Rexhaj - "Vëllezërit Frashëri" Deçan
 - 2. Loris Lokaj - "Tafil Kasumaj" Deçan
- Vemëndje: Si anëtare e ekipit të Kosovës në EGMO, në Olimpiadën Matematike të Kosovës për klasën e XII do të marrë pjesë nxënësja Erza Imeraj nga IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan. Të gjithë nxënësve ju urojmë suksese në OMK 2026!
Në fund falënderojmë të gjithë ata që ndihmuan në mbarëvajtjen e garës.
Deçan: 14-12-2025 Koordinator i garës: Prof Muharrem Kukalaj
- Memorandum Bashkëpunimi
E dhe ketë vit Drejtoria Komunale e Arsimit, nënshkroi një Memorandum Bashkëpunimi me OJQ-në "AGIMI" nga Isniqi.
Qëllimi i këtij memorandumi është "Ndërtimi i besimit ndërmjet komuniteteve dhe luftimi i dhunës me bazë gjinore përmes promovimit të trashëgimisë kulturore".
Projekti përfshin shkollat e Komunës së Deçanit.
- Zyrtarët e DKA-së zhvilluan një takim pune me Këshillin Pedagogjik, Psikologjik dhe Logopedik në nivel shkollash.
Ndër të tjera, me theks të veçantë, u diskutua për fillimin e procesit të Vlerësimit të Performancës së Mësimdhënësve, i cili ka nisur me sukses.
DKA vlerëson lartë angazhimin e KPPL-së.
- Bashkëpunimi me KFOR-in Italian vazhdon
- Drejtori, z. Besnik Hulaj, së bashku me zyrtarët e DKA-së, mbajtën një takim pune me drejtorët e shkollave të Deçanit.
Gjatë takimit u diskutua mbi zhvillimin e procesit arsimor, përfshirë procesin e VPM-së, mundësitë për trajnime në interes të mësimdhënësve për zhvillimin e tyre profesional, furnizimin e shkollave me dru për ngrohje, si dhe çështje të tjera me rëndësi për procesin arsimor.
- Psikologet znj. Besarta Tahirukaj - Idrizi znj. Begije Osaj - Januzaj dhe znj. Qëndresa Cacaj - Berisha, ishin pjesë në takimin vjetor të psikologëve shkollor, të organizuar nga Shoqata e Psikologëve të Shkollave të Kosovës (SHPSHK), që e mbajt në UP - Fakulteti Filologjik.
Ky takim kishte si qëllim lansimin e formularëve të punës të unifikuar për psikologët shkollorë në Kosovë, një iniciativë që do të ndihmojë në standardizimin e praktikave dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimeve për nxënësit.

- Në ambientet e Komunës, nxënësit e shkollës fillore “Isa Boletini” duke përfaqësuar të gjitha shkollat tona, organizuan një aktivitet të veçantë për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Pavarësisë.

Me këngë, valle dhe recitime emocionuese, ata na rikthyen në momentet historike që formësuan identitetin tonë kombëtar.

Faleminderit të gjithë nxënësve dhe mësuesve për përkushtimin dhe pasionin e tyre për të mbajtur gjallë shpirtin e kësaj dite të shenjtë!

Organizimie për nder të 28 Nëntorit – Ditës së Pavarësisë, aktivitete u zhvilluan në të gjitha shkollat e komunës sonë.
- Një hap drejt Ndërgjegjësimit!

Data 3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare të Personave me Nevoja të Veçanta, u shënua në të gjitha shkollat e komunës sonë.
- Fondi i Kosovës për Efiçencën e Energjisë: “Ide të Ndrtitshme për një të Ardhme të Gjëlber”

Nxënësja Ajlina Selmanaj ka arritur një sukses të veçantë në garën për efiçencë të energjisë, ku fitoi vendin e tretë në nivel nacional në kategorinë e instalacionit.

Ky rezultat është arritur falë bashkëpunimit të saj të ngushtë me arsimtaren e artit Ardijana Binakaj, si dhe përkrahjes së vazhdueshme nga Drejtorja e Arsimit në Deçan dhe drejtori i shkollës Agron Selmonaj.

Projekti i saj kreativ për energjinë e ripërtëritshme u vlerësua për qasjen inovative dhe mesazhin e fortë për mbrojtjen e mjedisit.
- Sfida Bebras Kosova 2025

Një ngjarje që bashkon mijëra nxënës në mbi 75 shtete të botës, për të zhvilluar mendimin logjik, kreativitetin dhe aftësitë digjitale përmes detyrave sfiduese dhe argëtuese.

Mentorja e sfidës nga shkolla “Drita”, Albulena Mataj grumbullon këto rezultate:

Në rajonin e Pejës, Deçani zë vendin e 1-rë në nivelin KASTORËT.

Komuna e Deçanit është renditur në vendin e 5-të në nivelin KASTORËT (së bashku me katër komuna të tjera), nga komunat pjesëmarrëse në nivel vendi.

Nga niveli Kastorët 3-4, nxënëset më të suksesshme ishin:

Blina Jasiqi- klasa IV (e cila e rendit Komunën e Deçanit në vendin e V-të)

Esma Hasanaj- klasa IV

Alea Mushkolaj- klasa IV

Në nivelin Benjaminët 5-6, nxënësja më e suksesshme nga shkollat pjesëmarrëse të komunës sonë ishte Elisa Avdiu.
- SHFMU “Maxhun Çekaj” nga Irzniqi ka arritur një rezultat për t’u krenuar, duke zënë vendin e dytë në nivel Republike në garat e pingpongut.

Ky sukses është fryt i përkushtimit, disiplinës dhe punës së palodhur të nxënësve tanë, si dhe i angazhimit profesional e pa kompromis të profesor Venon Lushaj, i cili vazhdimisht kontribuon në zhvillimin e sportit shkollor.

Urime nxënësve dhe profesorit për këtë arritje të madhe!

Ju dëshirojmë edhe shumë suksese të tjera në të ardhmen!

- 10 Dhjetori është Dita Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut, kjo ditë në shkollat tona u shënuar me aktivitete të nxënësve të organizuara nga mësimdhënësit e tyre.
- Në historinë e sportit të shkollave të mesme
Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri” – Deçan shënon një arritje vërtet triumfale, duke u shpallur KAMPION për të pestin vit rresht në garat Regjionale dhe Republikane në Hendboll (Djemtë)!
Djemtë tanë të jashtëzakonshëm do ta përfaqësojnë Kosovën në Kampionatin Botëror që mbahet në Ohër, Maqedonia e Veriut, një nder i madh për shkollën, komunën dhe gjithë vendin.
Ju jeni krenaria jonë!
Urime Aktivitet të Ed Fizike, profesorëve të gjimnazit, nxënësve dhe gjithë ekipit për punën e palodhshme dhe sukseset e pandalshme!
- Drejtoria Komunale e Arsimit, në bashkëpunim me znj. Mihane Dautaj në udhëheqjen e Psikologës shkollore znj. Begije Osaj - Januzaj, u realizua një aktivitet të veçantë në nder të Ditës Botërore të Personave me Nevoja të Veçanta, një ditë që na kujton dashurinë, forcën dhe vlerën që këta fëmijë sjellin çdo ditë në shkollën tonë.
Me shumë respekt ndamë mirënjohje për fëmijët dhe familjet e tyre, për guximin dhe përkushtimin që tregojnë vazhdimisht.
Falënderim i posaçëm shkon për mësuesen që punon çdo ditë me këta fëmijë, duke u bërë mbështetje, motivim dhe dritë në rrugëtimin e tyre.
Gjithashtu, falënderojmë Drejtorin e Arsimit, z. Besnik Hulaj, si dhe zyrtarët e lartë të arsimit, për mbështetjen e tyre të vazhdueshme në çdo aktivitet dhe për përkushtimin ndaj përfshirjes dhe mirëqenies së fëmijëve tanë.
Së bashku po ndërtojmë një komunitet më të ndjeshëm, më gjithëpërfshirës dhe më human
- Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj dhe Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, edhe këtë vit ndanë mirënjohje për të gjithë ata që këtë vit kontribuan me donacione për shkollat e komunës sonë.
Kryetari Ramosaj tha: - Kontributi juaj ka ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e kushteve të arsimit për fëmijët tanë.
Faleminderit për zemërgjerësinë dhe përkushtimin tuaj!
- 217 bursa në vlerë nga 400 euro për studentët meritore të Komunës së Deçanit.

Mbështetja e të rinjve dhe studentëve është një nga synimet dhe prioritetet e qeverisjes time.

Duke pasur parasysh nevojat dhe sfidat e studentëve dhe për të ju krijuar atyre mundësi më të mira financiare për mbulimin e shpenzimeve të studimeve, me një planifikim të duhur buxhetor dhe me hartimin e rregullores për ndarjen e bursave, kemi arritur ta rrisim numrin e përfituesve dhe vlerën e bursës komunale.

Ky është edhe një premtim i dhënë para qytetarëve, i cili tash e katër vite po përmbushet. Urime për të gjithë studentët përfitues!

- Tryezë e përbashkët në mes DKA-së dhe Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK) Në kuadër të aktiviteteve të parapara me komunat, përkatësisht mbështetjes profesionale për DKA-të dhe shkollat, Instituti Pedagogjik i Kosovës (IPK) vazhdon realizimin e katër tryezave të fundit të planifikuara për këtë vit akademik.

Qëllimi i këtyre tryezave është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet IPK-së, DKA-ve dhe shkollave, me fokus të veçantë në përmirësimin e performancës së shkollës, sidomos në fushën e lexim-kuptimit dhe lexim-shkrimit.

Përmes kësaj tryeze u synua të prezantohën studimet e IPK-së, të shkëmbehen ide dhe përvoja rreth praktikave të mira të zbatimit në shkollë/klasë, si dhe të identifikohën fusha dhe tema të përbashkëta bashkëpunimi për të adresuar sfidat aktuale dhe për të planifikuar aktivitete të ardhshme profesionale. IPK dhe DKA janë të përkushtuara që gjatë vitit shkollor 2025–2026 të realizojë aktivitete profesionale të rregullta në bashkëpunim me Komunen e Deçanit.

Tryeza kisht për temë bosht:

“Avancimi i performancës së shkollës bazuar në dëshmi: përvoja dhe praktika”.

Si nëntema të mundshme, të cilat mund t'i përzgjedhim së bashku, me ju janë:

- Strategji dhe metoda të mësimdhënies – me fokus te lexim-kuptimi dhe lexim-shkrimi;
- Planifikimi zhvillimor i shkollës;
- Vlerësimi i performancës së shkollës;
- Licencimi, zhvillimi profesional dhe vlerësimi i performancës së mësimdhënësve;
- Krijimi i rrjeteve profesionale në nivel të DKA-së dhe shkollave;
- Gjithëpërfshirja në edukimin e hershëm;
- Tema të tjera me interes, të propozuara nga DKA-të.

Në tryezë pjesëmarrës ishin 40 mësimdhënës të niveleve të ndryshme, drejtor shkollash, pedagogë, psikologë dhe zyrtarë të DKA-së.

Për rendësinë e tryezës dhe bashkëpunimit me IPK-në në veçanti foli Koodinatori për cilësi në arsim z. Zeqë Malaj.

- Urimi i Drejtorit të DKA-së z. Besnik Hulaj për Vitin e Ri 2026
Është kënaqësi dhe privilegj për ne t'ju urojmë juve dhe familjeve tuaja: Gëzuar Vitin e Ri 2026!
Në këtë prag ndërrimi vitesh, teksa reflektojmë mbi rrugëtimin tonë të përbashkët, ndihemi krenarë për transformimet pozitive në shkollat tona. Këto institucione sot vlerësohen më shumë se kurrë nga komuniteti, institucionet lokale dhe qendrore.

Viti që po lëmë pas ka sjellë arritje të rëndësishme, veçanërisht në:

Fushën e mësimnxënies dhe garave të diturisë e sportive.

Investimet në shkolla, me fokus të veçantë në dixhitalizimin e tyre.

Përmirësimin e kushteve të procesit mësimor, në përputhje me planin zhvillimor të arsimit komunal.

Përmirësimi i sigurisë në shkolla dhe rritja e efikasitetit të ambienteve të brendshme vazhdojnë të jenë ndër prioritetet tona kryesore. Po ashtu, mbështetja për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, përmes ofrimit të asistentëve, ka qenë model në nivel vendi.

Krenarë jemi edhe për zhvillimin profesional të mbi 200 mësimdhënësve, përmes trajnimeve të organizuara gjatë vitit 2024, një proces që do të vazhdojë edhe në vitet në vijim.

Duke hyrë në vitin 2025, jemi të bindur se do të vazhdojmë përpjekjet tona për të ngritur standardet arsimore dhe për të realizuar objektivat e përbashkëta.

Me mirënjohje për përkushtimin dhe punën e të gjithëve: nxënësve, mësimdhënësve, punonjësve teknikë, sekretarëve, drejtorëve, prindërve të nderuar, si dhe bashkëpunëtorëve vendorë e ndërkombëtarë, Policia, FSK dhe KFOR-i,

Gëzuar Vitin e Ri 2025!

Me respekt,

DKA - Deçan

(Aktivitetet e shënuara në raport janë të publikuara në faqen e Facebook-ut të DKA-së [https://www.facebook.com/Drejtoria e Arsimit në Deçan](https://www.facebook.com/Drejtoria_e_Arsimit_në_Deçan))

Të ndryshme:

- Shpallje të rezultateve të konkurseve (<https://decan.rks-gov.net/> <https://decan.rks-gov.net/njoftimet-konkurset/>)
- Vendime të komisioneve intervistuese
- Vendime të lehonisë
- Aktvendime për pensionim
- Aktvendime të ndryshme
- Vendime të ndryshme
- Njoftime të ndryshme (për ushqim, udhëtim, inflacion, gradim,etj)
- Hartimin e pëlqimeve të ndryshme
- Hartimin e kërkesave të ndryshme

Ndryshime në listat e pagave:

- Punëtor të rinjë
- Punëtor të larguar
- Ndryshime në listën e pagave
- Retroaktive
- Transfer bankar

Donacione

DONACION NGA KFOR-i ITALIAN, PAJISJE DIXHITALE

Në SHFMU “Dëshmorët e Baballoqit” në Baballoq, është bërë pranimi i donacionit të ri, nga KFOR-i nga Prishtina, Peja Komanda Regjionale - Përëndim.

Në Ceremoni kanë marrur pjesë Komandanti i Komandës Regjionale - Përëndim Kolonel Gabriel VACCA, Shefi i CIMIC-ut në Komandën Regjionale - Përëndim 1° LGT Saverio RUGGIERO si dhe oficer tjerë të KFOR-it Prishtinë, Pejë në Kosovë, Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, drejtori i shkollës z. Agron Selmonaj, mësimdhënës, nxënës dhe prindër.

Drejtori Hulaj me këtë rast falënderoi Komandantin VACCA për prezencën dhe KFOR-in si mik nga Prishtina, Peja për këtë donacion dhe për ndihmën që ka ofruar për qytetarët e Kosovë me theks të veçantë qytetarët deçanas, si në aspektin e sigurisë ashtu edhe në fusha tjera pa i harruar shkollat.

Drejtori Hulaj në emër të Kryetarit Ramosaj, vlerësoi lartë bashkëpunimin që ka pasur KFOR-i si mik Prishtinë, Pejë me Komunën e Deçanit edhe në të kaluarën dhe u shpreh i gatshëm që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen, me qëllim të realizimit të projekteve të dobishme që ndikojnë në përmirësimin e jetesës së qytetarëve.

Ne emer të Shkollës Drejtori Agron Selmonaj, falenderoi shumë Komandantin për bashkëpunimin e sinqertë që treguan në realizimin e këtij donacioni.

Të gjitha paisjet do të jenë ndihmë e madhe në zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë bashkohore.

Në kuadër të këtij projekti janë dhënë pajisje për Kabinetin e Gjeografisë si: Llaptop i serisë së fundit, printer dhe projektor.

Përfitues i projektit është edhe IAAP “Tafil Kasumaj”

Nën kordinimin e Koordinatorit për AAP-së dhe bashkëpunim me sektorin privat, Z. Blerim Haliti, Projekti ALLED2 ka filluar fazën e tretë të liferimit të pajisjeve së teknologjisë së fundit.

Në këtë fazë do të përfitojnë edhe 10 IAAP, 3 QAP-a dhe 2 fakultete të UP-së. Pas instalimit dhe funksionalizimit të pajisjeve do të vazhdohet me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve dhe instruktorëve përmes trajnimeve specifike dhe të specializuara nga ekspert vendor dhe ndërkombëtar.

Projekti ALLED2 është tregim suksesi në reformimin e AAP-së në Kosovë.

E ardhmja është në shkollat tona sot!

-Donacion kompjuter (PC) nga Universteti "Haxhi Zeka" në Pejë në shkollën “Jusuf Gërvalla” në Prapaqan dhe shkollën “Dëshmorët e Kombit” në Strelc i Ulët.

Me këtë rast, u funksionalizua kabineti e TIK-ut dhe janë pajisur me kompjuter: salla e mësimdhënësve, klasat dhe biblioteka.

Falemindrojmë Rektorin e UHZ prof. Dr. Armand Krasniqi, Prorektori prof. Dr. Edmond Beqiri, prof. Erzen Krasniqi.

-Donacion nga Kolegji Maerlant - Holandë, për shkollën "Bajram Curri" në Strellc të Epërm, Kjo falë z.Berat Hasan Hasanramaj i cili grumbulloi mjete të vlefshme shkollore si : Desktop digjital, Tv, Lp, Kompjuter, Projektor, Mikroskopa, Tabela magnetike, Karrige, Tavolina dhe shumë mjete tjera të konkretizimit.

Ky donacion nuk do ishte realizuar pa ndihmën e pa kursyer të djemve të Shoqatës "Haki Povataj" me seli në Zvicër dhe krytarit të ndëruar z. Ozmon Ukaj, të cilët paguan transportin deri në shkollë.

Kryetari i Komunës z. Bashkim Ramosaj bashkë me drejtorin e DKA-së z. Besnik Hulaj, nderuan me mirënjohje në shenjë falenderimi, në një rast solemn institucione, organizata, shoqata nderkombëtare e vendore dhe njerz të vullnetit të mirë, të cilët ndihmuan në forma të ndryshme shkollat e komunës sonë nder vite.

Nuk ishin të pakët mbi 350 vullnetmirë!

DKA edhe një herë falenderon të gjithë ata që ndihmuan shkollat pa dallim.

Rrugëtojmë bashkë tutje.

Faleminderit!

RAPORT I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT 2025, SEKTORI I ARSIMIT

GRANTET

QEVERITARE/Fondi 10 /

SEKTORI I ARSIMIT, KOMUNA DEÇAN

N r.	Programi/Nënprogrami	Kodi ek.i Nënprogramit	Buxheti Planifikuar	Aktuali/Shpenzimet (Janar-Nentor)
I.	Administrata e Arsimit	92075		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		64107.11	57674.47
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		15000,00	14994.58
II.	ARSIMI FILLOR	93420		
1.	11 PAGA DHE SHTESA		3859729.76	3675241.58
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME		105000,00	104997.02
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE		25000,00	25000.00
	300 / PROJEKTET KAPITALE		34216,00	34216,00

II	ARSIMI	I			
I.	MESËM		94620		
1.	11 PAGA DHE SHTESA			942473,70	834680.66
2.	13 MALLRA DHE SHËRBIME			56950,00	56950.00
3.	14 SHPENZIME KOMUNALE			10000,00	9999.61

• **Investimet kapitale-**

Gjatë muajit janar – dhjetor 2025 në Drejtorin e Arsimit janë realizuar këto projekte kapitale:

-Është bërë perurimi i SHFMU “Lan Selimi” në Lumbardh.

-Ka përfunduar ndertimi i rrethojës së SHFMU “Ardhmëria” në Beleg.

- Me investimin e Komunës dhe MASHTI-T kanë përfunduar punimet në shkollën "Dëshmorët e Baballoqit" në Baballoq.

Lyerja e brendshme, dyert, ndriçimi në shkollë dhe inventari i administratës kanë qenë pjesë e projektit.

-Po vazhdojnë punimet në ndërtimin e punëtorive dhe sallës së sporteve në IAAP “Tafil Kasumaj” në Deçan.

- Në nderim të “Epopesë së Dukagjinit”, komuna e Deçanit në bashkëpunim me DKA-në, organizuan aktivitetin sportiv, tashmë tradicional, krosin “Rruga e Lirisë” me nxënësit e shkollave fillore.

Po ashtu u hap e ekspozita “Marsi Lirisë”, me punime të nxënësve kushtuar Epopesë së Dukagjinit. Nderimi i dëshmorëve të rënë për liri është simbolika e kësaj gare.

Nxënësit e Gjimnazit “Vëllezërit Frashëri” katër vite radhazi kampion: 2022, 2023, 2024, 2025

"Gjimnazi Vëllezërit Frashëri" Kampion i Republikës së Kosovës - në Hendboll, ekipi i djemve Gjimnazi Vëllezërit Frashëri e perfaqson Kosovën në garat ndërkombëtare në Hendboll (Djemt) për të tretin vit Radhaz!

Urimi i drejtroit të Drejtorisë Komunale të Arsimit z. Basnik Hulaj drejtuar nxënësve deçanas me rastin e përfundimit të gjysëvjektorit të parë dhe festive të fundvitit
Të nderuar nxënës, prindër, mësuesdhënës dhe staf arsimor,

Me përfundimin e suksesëshëm të gjysmëvjetorit të parë të vitit shkollor, shprehim falënderimin dhe vlerësimin tonë më të lartë për angazhimin, punën dhe përkushtimin tuaj të vazhdueshëm. Ky gjysmëvjetor dëshmoi edhe një herë se bashkëpunimi ndërmjet shkollave, Drejtorisë Komunale të Arsimit, prindërve dhe nxënësve është çelësi i arritjeve dhe suksesit në procesin edukativo arsimor.

Nxënësve u urojmë suksese të mëtjshme në rrugëtimin e tyre arsimor, mësimdhënësve dhe stafit të shkollave u shprehim mirënjohjen për punën e palodhshme, ndërsa prindërve falënderim për mbështetjen e vazhdueshme.

Në prag të festave të fundvitit, ju urojmë shëndet, gëzim, harmoni familjare dhe suksese në vitin që po vjen. Urojmë që viti i ri të na sjellë më shumë arritje, mirëkuptim dhe mbarësi në fushën e arsimit.

Gëzuar festat e fundvitit dhe suksese në vazhdim!

Drejtorja Komunale e Arsimit – Deçan

Njoftimi drejtorive të shkollave për sms-ve

Përshëndetje të nderuar/a,

Uroj të jeni mirë dhe punët të ju shkojnë mbarë këtë fillim vit!

Me datën 03.12.2024, ju kam derguar për e-mail njoftimin për Garat e Fizikës 2025,

Sot është dita e fundit që duhet t'i dergoni emrat e nxënësve garues për Garat komunale, të cilat mbahen me 18.01.2025 në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri".

Për informata shtesë ju njoftoj me kohë.

Me respekt, (10.01.2025)

Të nderuar/a,

Uroj të jeni mirë me shëndet dhe punët të ju shkojnë mbarë,

Ju lutëm i kontrolloni e-mailat e juaja, në menyrë që të mos mbetemi prapa me punët tona,

Me respekt,(13.01.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni njoftimin për takimin e nesërm.

Me respekt, (13.01.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjëni NJOFTIMIN nga MASHTI.

KUJDES NË RRJEDHJEN E INFORMATAVE TË NDIESHME!!!

Me respekt, (15.01.2025)

Të nderuar/a,

Ju lutëm i njoftoni nxënësit e klasës së IX-të, X-të, XI-të dhe XII-të, të cilët i keni përzgjedhur nga shkolla juaj për Garën Komunale të Fizikës 2025 se,

Garat mbahen në Gjimnazin "Vëllezërit Frashëri" në Deçan, nesër ditë e shtunë, datë 18.01.2025, me fillim në ora 11:00.

Nxënësit duhet të paraqitën në shkollë jo më vonë se në ora 10:30, duhet të kenë se paku një stilolaps dhe një shishe uji me vete.

Suksese për nxënësit!

Me respekt,(17.01.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin nga MASHTI për organizimin e Olimpiadës së përbashkët të Gjuhës Shqipe - Kosovë - Shqipëri, për klasat e 9-ta.

Ju lutëm e shpërndani me mësimdhënësit e Gjuhës Shqipe,

Me respekt, (22.01.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja i gjeni dy kërkesa me rëndësi!

Ju lutëm të reflektoni me përgjegjësi.

Me redpekt,(23.01.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin nga QKMF "Adem Ukëhaxhaj" rreth vaksinimit të fëmijëve.

Me respekt, (27.01.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja i gjëni dy kërkesa,

Ju lutëm i respektoni afatet kohore!

Me respekt,(03.02.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni një kërkesë nga MASHTI,

Ju lutëm e shpërndani të mësimdhënësit e shkollës tuaj.

Me respekt,(05.02.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin nga Zyra kontaktuese e Komunës sonë dhe Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Ju lutëm i kushtoni vemendje të veçantë!

Me respekt, (12.02.2025)

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se sot 13.02.2025, kemi takim pune me fillim në ora 11:00.

Tema takimit është - organizim për nder të 17 Shkurtit,

Ju lutëm, kush nuk mundet të jetë në takim na njoftoni!

Me respekt, (13.02.2025)

Të nderuar/a,

Uroj të jeni mirë,

Ju rikujtoj se sot me fillim nga ora 10:00, në vigjilje të 17 Shkurtit, në Sallën e Asamblesë, shfaqet pragram nga nxënësit e IAAP "Tafil Kasumaj".

Jeni të ftuar ju, Këshilli i nxënësve dhe ndonjë mësime dhënë që është i lirë në këtë kohë.

Ju mirëpresim,(14.02.2025)

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se:

Edukatoret, psikologët, pedagogët dhe asistentët për fëmijë me nevoja të veçanta, nuk duhet ta ndjekin trajnimin për kurrikulë,

Për këtë kategori organizohet trajnim i veçantë.

Me respekt,(14.02.2025)

Të nderuar/a,

Me datën 07.02.2025, ju kam derguar kërkesën nga Caritasi për plotësimin e formularit me të dhëna për klasën përgatitore/parafillor.

Vetëm 7 shkolla i kanë dergu formularët e plotësuar!!!

Afati ishte deri me datën 13.02.2025!

Ju lutëm reflektoni në kërkesat që ju vinë nga DKA.

Me redpekt,(13.02.2025)

I/e nderuar,

Uroj të jeni mirë me shëndet dhe punët të ju shkojnë mbarë,

Në e-mail e gjeni listën emrore nga stafi i shkollave tuaja të cilët janë pensionuar në periudhën 07 Mars 2024 dhe 07 Mars 2025,

Ju lutëm nëse kemi edhe ndonjë pensionist nga shkollat tuaja e bashkangjiteni në listë,

Me respekt, (24.02.2025)

I/e nderuar,

Në e-mailat e juaja i gjëni dy kërkesa,

E vlerësoj bashkëpunimin tuaj,

Me respekt, (04.03.2025)

I/e nderuar,

Ju lutemi të njoftoni mësime dhënësit dhe stafin e shkollës që janë pensionuar nga 7 mars 2024 deri më 7 mars 2025,

Të enjtën më 7 mars 2025, në orën 10:00, në Sallën e Asamblesë, do të organizohet ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve për të pensionuarit.

Të ftuar në këtë ceremoni janë të gjithë drejtorët, si dhe çdo mësime dhënësit që është i lirë në atë

kohë.

Listën me emra e gjëni në messenger të grupi i drejtorave.

Ju mirëpresim! (05.03.2025)

I/e nderuar,

Në e-mailat e gjeni një njoftim-kërkrësë për Olimpiadën Kombëtare të Gjuhës Shqipe për klasat e 9-ta.

Me respekt, (06.03.2025)

I/e nderuar,

Në e-mailat e gjeni VENDIMIN e Drejtorit z. Besnik Hulaj, për ndalimin e dhuratave të kushtueshme për mësimdhënës nga nxënësit për festat 7 dhe 8 Mars.

Me respekt, (06.03.2025)

I/e nderuar,

Ju njoftoj se testet për fazën e parë në nivel shkolle për Olimpiadën Kombëtare të Gjuhës Shqipe, për klasat e 9-ta, janë të gatshme pas orës 13:00 sot,

Ju pres t'i merni ju personalisht.

Besoj se ju komisionet për vlerësim i keni zgjedhur,

Për pakjartsi më kontaktoni?

Me respekt, (10.03.2025)

I/e nderuar,

Uroj të jeni mirë me shëndet,

Sipas agjendës që tani është e njohur për ju,

Sot, zhvillohet gara në OKGjSh për klasat e 9-ta,

Ju i keni bërë të gjitha përgatitjet që gara të zhvillohet sipas planit,

Ju e keni një komision për monitorimin e garës dhe vlerësimit të testit që veç është të ju,

Komisioni duhet të jetë i përbërë prej 3 anëtarëve nga Fusha Gjuha dhe Komunikimi,

Gara fillon në ora 9:00 dhe përfundon në ora 11:00,

Në ora 11:00, ne ju dërgojmë çelsin e përgjigjeve të testit,

Për garën komunale nuk duhet të jenë më shumë së tre nxënës nga shkolla juaj bazuar në rezultatet e treguara në test.

Të gjitha procesverbalet e procesit të garës i ruani për verifikim nga zyrtarët e DKA-së,

Gara Komunale mbahet me 22.03.2025,

Ju lutëm të beni ndonjë fotografi gjatë zhvillimit të garës dhe i dergoni në viber,

Ju shkoftë mbarë dhe suksese për nxënësit!

Me respekt,(11.03.2025)

I/e nderuar,

Ju njoftojmë se Faza e Dytë e OPGJSH në nivel komune do të mbahet më datë 20.03.2025 (e enjte), në Sallën e Asamblesë Komunale, nga ora 09:00 deri në ora 11:00.

Nxënësit e përzgjedhur nga shkolla, së bashku me një mësimitdhënës përcjellës, duhet të paraqiten në qendrën e testimimit më së voni në orën 08:30.

Çdo nxënës duhet të ketë me vete të paktën një stilolaps.

Suksese për të gjithë nxënësit!

JU LUTËM E KONFIRMONI PRANIMIN E KETIJ NJOFTIMI (18.03.2025)

I/e nderuar,

Me datën 25.03.2025 ju kam derguar në e-mail një kërkesë nga MASHTI, për Trendin e Migrimin të nxënësve dhe stafit të shkollave!

Kemi pranuar informata vetem nga 11 shkolla!

Ju lutëm e respektoni afatin kohor të përgjigjeve nga Kërkesat zyrtare që ju vinë nga DKA!

E dini që jeni në kohen e Vlerësimit të Performances së drejtorëve, në një nga standardet e punës suaj është edhe bashkëpunimi me DKA!!!

Me respekt, (01.04.2025)

I/e nderuar,

Të premten me 11.04.2025 ju kam derguar një kërkesë për plotësimin e një tabelari,

Pres në bashkëpunimin tuaj!

Me respekt,(14.04.2025)

I/e nderuar,

Në e-mailat e juaja i gjeni disa shkresa që duhet t'i keni në konsideratë.

Suksese!

Me respekt,(22.04.2025)

I/e nderuar,

Në e-mailat e juaja e gjeni një kërkesë nga MASHTI,

Ju lutëm e shpërndani të mësimitdhënësit tuaj,

Me respekt,(22.04.2025)

I/e nderuar,

Në e-mailat e juaja e gjeni një kërkesë të meherishme nga MASHTI, të cilës detyrimisht duhet t'i përgjigjeni në afatin e paraparë!!!

Me respekt, (28.04.2025)

Ju RIKUJTOJ se OPINIONET për tekstet mësimore për klasat 1-12, bashkë me formularin e gjeni në e-mailat e datës 19.09.2024.

Punë të mbarë!(28.04.2025)

I/e nderuar,
Në e-mailat e juaja e gjeni NJOFTIMIN për zbatimin e Kalendarit të Vitit Shkollor 2024/2025!
Me respekt,(30.04.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni VENDIMIN e bazuar në UA MASHTI 02/2016.
Me respekt,(06.05.2025)

I/e nderuar,
Ju lutëm i njoftoni mësimdhënësit/et e klasave të para se:
Nesër e enjte, me 08.05.2025 kemi takim informues për Festën e Abetarës 2025,
Takimi mbahet në Sallën e Asamblesë në ora 12:00,
Pjesëmarrja është e obliguar!
Me respekt,(07.05.2025),

I/e nderar,
Në e-mailat e juaj e gjeni tabelën për plotsim të normativit për vitin shkollor 2025/2026.
Ju lutëm ta respektoni afatin kohor!
Me respekt,(13.05.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjëni një kërkesë me prioritet,
Ju lutëm të jeni bashkëpunues?
Me respekt,(13.05.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni kërkesën nga MASHTI për planifikimin e paraleleve dhe numrit të nxënësve për regjistrim në klasën e parë, të vitit shkollor 2025/2026,
Ju lutëm t'i përmbahi afatit kohor!
Me respekt,(15.05.2025)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se nesër e Marte, 27.05.2025 në ora 11:00, në Sallën e Asamblesë, mbahet ceremonia e certifikimit nga Trajnimi i Kurtikulës.
Pjesmarrja është obligative!
Me respekt,(26.05.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni një njoftim me rendësi të veçantë!
Me respekt,(26.05.2025)

Të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë dhe që punët t'ju ecin mbarë!

Ju njoftojmë se kemi pranuar një vërejtje nga MASHTI lidhur me mosregjistrimin e të dhënave në sistemin SMIA nga pesë shkolla, të cilat ende nuk e kanë filluar regjistrimin e suksesit për fundin e gjysmëvjetorit të dytë.

Ju njoftojmë se sistemi do të jetë i hapur deri më 11.07.2025!

Faleminderit për mirëkuptimin!

Me respekt,

Të nderuar/a,

Uroj të jeni mirë,

E kuptoj që jeni në pushim, por e kemi një kërkesë me PRIORITET nga MASHTI!

Në e-mailat e juaja e gjeni një tabelë të cilën e plotësoni më të dhënat e koordinatorëve, që i emroni për qasje në e-Kosova dhe e dërgoni në e-mailin tim zyrtar Ramiz.Bajramaj@rks-gov.net

E lexoni e-mailin më kujdes, për çdo pa qartësi më kontaktoni.

Ju lutëm e respektoni afatin kohor!

Më respekt,

Të nderuar/a,

Uroj të jeni mirë me shëndet ju dhe familjet e juaja,

Në e-mailat e juaja e gjeni një njoftim/VEREJTJE!

Me respekt, (21.07.2025)

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se në e-mailat e juaja e gjeni një kërkesë zyrtare nga DKA.

Ju lutëm ta respektoni afatin kohor!

Me respekt, (23.07.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni DOKUMENTIN E PËRDITËSUAR me rendësi të veçantë,

Ju lutëm afatin kohor ta respektoni!

Me respekt, (08.08.2025)

Të nderuar/a,

Edhe një herë ju dergova në e-mail kërkesën dhe një tabelë, me tri shkolla si model për ta plotësuar, Me respekt, (13.08.2025)

Të nderuar/a,

Ju njoftojmë se nga data 15 gusht 2025, është i hapur sistemi SMIA për regjistrimin e të dhënave për sukses të periudhës fundi i vitit shkollor - gusht, si dhe për regjistrimin e numrit të orëve të planifikuara dhe të mbajtura për vitin shkollor 2024/25.

Sistemi do të jetë i hapur deri më datën 08.09.2025.

Qasja në sistemin SMIA bëhet përmes linkut:

<https://smia.rks-gov.net>

Me respekt,(13.08.2025)

Të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet,
Në e-mailat e juaja i gjeni disa kërkesa, të cilave ju përgjigjeni gjatë ditës,
Me respekt, (18.08.2025)

Të nderuar/a,
Ju lutëm i kontaktoni koordinatorët për qasje në eKosova, a i kanë pranuar në e-mailat e tyre linqet për aprovim të teksteve dhe mjeteve shkollore?
Në të kundertën me informoni t'a njoftojmë ministrinë.
Me respekt, (18.08.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja i gjeni UA për Kurrikulën me zgjedhje dhe listën e propozimeve për lëndet zgjedhore,
Me respekt, (18.08.2025)

Të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë dhe punët të ju shkojnë mbarë,
Në e-mailat e juaja e gjeni RIKUJTIMIN për mosrespektimin e UA MASHTI nr. 11/2023 Për Kurrikulën me zgjedhje!
Presim reflektimin tuaj,
Me respekt,(29.08.2025)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se ditarët e klasava janë ardh,
Ju presim në Sallën e Asamblesë SOT! Me respekt(29.08.2025)

Të nderuar/a,
Në adresën tuaj elektronike janë dërguar dy dokumente me rëndësi.
Ju lutemi që t'i shqyrtoni me kujdes dhe të veproni sipas udhëzimeve të përcaktuara.
Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj. Me respekt,(04.09.2025)

Të nderuar/a
Në adresën tuaj elektronike e gjeni një tabelë, të cilën duhat ta plotësoni me të dhëna sipas kërkesave të tabelës,
Ju lutëm e respektoni afatin kohor!
Me respekt,(04.09.2025)

Të nderuar/a,
Në adresën tuaj elektronike e gjeni njoftimin për aktivizimin e sistemit SMIA për vitin shkollor

2025/2026.

Ju lutemi, lexoni me kujdes udhëzimet dhe respektoni afatin e përcaktuar.

Me respekt,(09.09.2025)

Të nderuar/a,

Ju njoftoj se në e-mailat e gjeni njoftimin nga MASHTI, për verifikimin e subvencionimit të teksteve dhe mjeteve shkollore, Me respekt,

Të nderuar/a,

Uroj të jeni mirë me shëndet.

Ju njoftojmë se procesi mësimor do të zhvillohet nesër sipas orarit të rregullt.

Komisioni Komunal i Zgjedhjeve (KKZ) ka njoftuar se të gjitha institucionet arsimore do të lirohen nga procesi zgjedhor më së voni sonte, në ora 22:00.

Me respekt,(12.10.2025)

Të nderuar/a,

Ju rikujtoj se sistemi SMIA do të jetë i hapur deri më 20.10.2025 për regjistrim, plotësim dhe ndryshim të të dhënave në shkollën tuaj.

Vërehet se në shumicën e shkollave:

- nuk është pastruar lista e personelit;
- ka emra të dyfishtë;
- figurojnë persona që janë pensionuar ose nuk punojnë më në shkollë;
- mungon regjistrimi i punonjësve aktivë;
- nuk është përditësuar gjendja fizike e objektit të shkollës;
- mungon regjistrimi i asistentëve në shkollat ku punojnë;
- si dhe regjistrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore.

Ju lutem që të bëni përditësimin e të gjitha të dhënave përkatëse brenda afatit të caktuar.

Për çdo paqartësi ose rast specifik, mund të më kontaktoni.

Me respekt,(14.10.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për Olimpiada XVIII Matematike e Kosovës - OMK 2026, Suksese! (20.10.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja i gjeni dy njoftime secila me rendësinë e vet.

Me respekt,(27.10.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat e juaja e gjeni Referencën Zyrtare nga Drejtori z.Besnik Hulaj.

Me respekt,(28.10.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për fillimin e monitorimit në shkolla nga muaj Nentor 2025,
Faleminderit për bashkëpunimin!
Me respekt, (30.10.2025)

Të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet dhe punët të ju shkojnë mbarë,
Në e-mailat e juaja e gjeni njoftimin për takim pune nga MASHTI me kryetarët e aktivitet të mësuesve të klasave 1 - 5, me datën 14.11.2025 me fillim në ora 10:00.
Me respekt,(10.11.2025)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se nesër e Enjtë, datë 12.11.2025 me fillim në ora 11:00 kemi takim pune,
Takimi mbahet në DKA,
Pjesëmarrja është OBLIGATIVE!
Me respekt,(11.11.2025)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se ka NDRYSHUAR DATA E TAKIMIT nga MASHTI me kryetarët e aktivitet të mësuesve të klasave 1 - 5, për nesër e Enjte me datën 13.11.2025 me fillim në ora 10:00 në Sallën e Asamblesë Komunale,
Shumë faleminderit në mirëkuptim,
Me respekt,(12.11.2025)

Të nderuar/a,
Uroj të jeni mirë me shëndet.
Ju lutëm që të na informoni shkurtimisht lidhur me gjendjen aktuale në shkolla pas reshjeve të djeshme të shiut, duke theksuar nëse ka:
- dëmtime eventuale në objekt,
- paraqitje të lagështisë apo rrjedhjeve,
- pengesa në zhvillimin e procesit mësimor,
- apo çështje të tjera që kërkojnë ndërhyrje.
Faleminderit për bashkëpunimin tuaj.
Me respekt,(19.11.2025)

Të nderuar/a drejtorë/e të shkollave,
Uroj të jeni mirë me shëndet dhe që punët t'ju ecin mbarë.
Ju njoftojmë se në adresat tuaja elektronike e keni pranuar kërkesën nga NMBNj, për dërgimin e të dhënave të nevojshme për planifikimin e plotësimit të stafit për vitin 2026.

Ju lutëm që të dhënat e kërkuara të jenë të sakta, të plota dhe të përditësuara, pasi ato do të shërbejnë si bazë për planifikimin dhe organizimin e mëtejshëm nga ana e Drejtorisë Komunale të Arsimit (DKA) dhe Njësia për Menagjimin e Burimeve Njërzore (NMBNj).
Po ashtu, ju lutëm ta respektoni afatin kohor të përcaktuar për dorëzimin e të dhënave, në mënyrë që procesi të zhvillohet në kohë dhe pa vonesa.
Faleminderit për bashkëpunimin tuaj të vazhdueshëm.
Me respekt, Drejtoria Komunale e Arsimit – DKA(02.12.2025)

Të nderuar/a,
Në e-mailat e juaja e gjeni kërkesën për KPSH dhe KDSH, të plotësoni formularin e bashkangjitur.
Ju lutëm e respektoni afatin kohor!
Me respekt,(04.12.2025)

Të nderuar/a,
Ju lutëm të na dërgoni numrin e mësimdhënësve që aktualisht janë në listën e pagave në shkollën tuaj, të ndarë sipas niveleve si më poshtë:
• sa mësimdhënës janë në nivelin 1–5;
• sa mësimdhënës janë në nivelin 6–9.
Këto të dhëna na nevojiten për momentin dhe ju lutëm t'i dërgoni këtu.
Gjithashtu, ju lutëm që planifikimet e stafit për vitin 2026 t'i dorëzoni në formë dokumenti të shkruar.
Ju faleminderit për bashkëpunim!(05.12.2025)

Të nderuar/a,
Ju njoftoj se të Henën, datë 08.12.2025 me fillim në ora 10:00 kemi takim pune,
Takimi mbahet në DKA,
Pjesëmarrja është OBLIGATIVE!
Me respekt,(05.12.2025)

Të nderuar/a,
Ju lutëm të na dërgoni emrat e nxënësve të klasave VII, VIII dhe IX, të cilët do të përfaqësojnë shkollën tuaj në Olimpiadën Komunale të Matematikës, e cila do të mbahet të shtunën, më 13.12.2025, në IAAP “Tafil Kasumaj”.
Për këtë garë është e nevojshme të përzgjidhen nga dy (2) nxënës për secilën gjeneratë.
Gjithashtu, ju lutëm të na dërgoni edhe numrin e mësimdhënësve që kanë përfunduar procesin e VPM-së, sipas kërkesës së SIA-së.
Ju faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.
Me respekt,(09.12.2025)

Të nderuar/a,

Ju lutëm t'i njoftoni nxënësit që i keni përzgjedhur për Olimpiadën Komunale të Matematikës, e cila do të mbahet nesër, e shtunë, më 13 dhjetor 2025, duke filluar nga ora 11:00.

Nxënësit duhet të jenë para shkollës në ora 10:30, për t'u sistemuar me kohë dhe për të zhvilluar testimin pa vonesa.

Testi do të zhvillohet në IAAP "Tafil Kasumaj".

Ju lutëm sigurohuni që nxënësit të kenë me vete:

- së paku dy stilolapsa ose lapsa të thjeshtë,
- një shishe uji për pije.

Telefonat janë të ndaluar gjatë gjithë kohës së testimit.

Me respekt,(12.12.2025)

Të nderuar/a,

Ju njoftojmë se nga sot është hapur Sistemi për Menaxhimin e Informatave në Arsim (SMIA) për regjistrimin e të dhënave mbi suksesin dhe mungesat e nxënësve për gjysmëvjetorin e parë të vitit shkollor 2025/2026, bazuar në Udhëzimin Administrativ (U.A.) Nr. 25/2013.

Ju lutemi që këtë njoftim ta delegoni menjëherë tek personat përgjegjës në kompetencën tuaj, me qëllim të plotësimit të të dhënave brenda afatit të përcaktuar.

Po ashtu, për mbështetje të planifikimit dhe politikave arsimore të bazuara në të dhëna, ju lusim që të përditësoni edhe të dhënat tjera administrative në SMIA, për të gjitha ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe.

Afati për regjistrimin e suksesit dhe mungesave: 24.12.2025 – 31.01.2026

Qasja në sistem:

- Përmes uebfaqes zyrtare të MASHTI, tek *Shërbime Digjitale – SMIA*
- Ose drejtpërdrejt përmes vegzës: <https://smia.rks-gov.net>

Ju rikujtojmë se SMIA është i hapur gjatë gjithë vitit për përditësimin e të dhënave tjera.

Me respekt,(24.12.2025)

Të nderuar/a,

Në e-mailat tuaj do t'i gjeni listat e pagave për muajin dhjetor 2025, të përgatitura veç e veç për secilën shkollë.

Ju lutemi t'i kontrolloni me kujdes listat për të verifikuar nëse të gjithë mësimdhënësit janë të përfshirë dhe nëse janë pasqyruar të gjitha ndryshimet përkatëse.

Në rast se vëreni ndonjë lëshim apo pasaktësi, ju lutemi të na njoftoni përmes e-mailit.

Ju falënderojmë për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

Me respekt,(26.12.2025)